

Dr. Albert Hitoaliaj



Njësia: sektori i botimeve dhe informimit publik, Qendra e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve.

Grada: Dr.

Funksioni: shef sektori

Kontakt: albert.hitoaliaj@aspo.gov.al

Biografia: Albert Hitoaliaj është diplomuar në “Bachelor” në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës (2002); ka përfunduar studimet Postmaster në “Marrëdhënie ndërkombëtare” (2009) dhe Postmaster në “Studime të sigurisë” (2011). Në vitin 2018 fiton gradën shkencore “Doktor” në fushën e sigurisë. Ka një eksperiencë shumëvjeçare në fushën e botimeve të Mbrojtjes (2002-2014), eksperiencë mësimdhënie në fushën e sigurisë, në Akademinë e Mbrojtjes (2011-12) dhe nga viti 2015 e në vazhdim është personel akademik i Akademisë së Sigurisë, duke qenë lektor i lëndës “Shkrim akademik” dhe shef i sektorit të botimeve në Qendrën e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve.

Ndër të tjera ka një eksperiencë të gjatë (që nga viti 2010) në aktivitete të pavarura kërkimore, jofitimprurëse, si drejtor ekzekutiv i qendrës studimore “Hapësirë”, - botuese e rreth 20 numrash të revistës kërkimore shkencore “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Ka mbi 20 vjet eksperiencë në fushën e botimeve dhe publikimeve dhe është autor i më shumë se 30 artikujve shkencorë, një botimi enciklopedik, dy monografish, bashkautor i tre librave, pjesëmarrës dhe koordinues në projekte të ndryshme shkencore si dhe autor i një numri të madh artikujsh e analizash në shtypin e përditshëm.

Fusha e kërkimit: siguria.

Lënda aktuale: Shkrim akademik.